

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË**

**“Vernici Superiori Italiani” Sh.P.K.**

*Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

*Sot më **09 nentor 2022**, unë Emilando Rica, shtetas shqiptar, lindur më 25.07.1994, banues në Lac, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal **J40725085C**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “për shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoj këtë Statut si vijon:*

*Në këtë Statut:*

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 ‘Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’ i ndryshuar
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë
- 

### **KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit, Selia**

*Sot, më **09 nentor 2022** unë, themeluesi i mësipërm, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar “VSI”.*

*Emilando Rica*



## *Neni 2*

### *Objekti*

*Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:*

***Import-Eksport, Tregetimin e bojrave, materialeve te ndertimit, sisteme Termoizolimi dhe Hidroizolimi. Rikonstrukcion fasadash objektesh te ndryshem.***

*Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.*

## *Neni 3*

### *Kohëzgjatja*

*Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.*

## *Neni 4*

### *Selia*

***Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lac Lagjja nr.6.Rruga Patokut, Ndertese private, zona kadastrale 2365,nr.pasurise 11/21.***

*Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.*

*Emilando Rica*



## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

*Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe zotërohet tërësisht nga ortakut themelues **Emilando Rica** : Zotërues i 1 (një) **kuote** me vlerë të përgjithshme 100.000 LEK që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

*Kontributi i ortakut është në para.*

*Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.*

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

*Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.*

*Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.*

*Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.*

*Emilando Rica*



## *Neni 7*

### ***Transferimi i kapitalit***

*Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:*

- *Kontributit në kapitalin e shoqërisë*
- *Shitblerjes*
- *Trashëgimisë*
- *Dhurimit*
- *Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.*

*Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.*

*Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.*

## ***Kreu III***

### ***Organet vendimmarrëse dhe drejtuese***

## *Neni 8*

### ***Organi vendimmarrës***

*Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.*

*Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.*

*Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:*

- a. *Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë*
- b. *Ndryshimet e statutit*
- c. *Emërimin e shkarkimin e administratorëve*
- d. *Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar*
- e. *Përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.*

*Emiliano Rıza*



- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Shpërndarjen e fitimeve vjetore
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

## Neni 9

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është ethirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Emilando Riza



## **Neni 10**

### **Kuorumi**

*Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.*

*Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.*

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

*Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë; emerimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likujduesve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; mitarimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.*

*Emiliano Rico*



## *Neni 12*

### *Përrjashtimi nga e drejta e votës*

*Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jot ë përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.*

## *Neni 13*

*Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Komëtare të Biznesit.*

*Personat e mëposhtëm caktohen si administrator të parë të shoqërisë për një mandate të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:*

- *Z. **Emilando Rica**, shtetas shqiptar, lindur më 25.07.1994 , banues në Lac, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal **J40725085C**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.*

*Emilando Rica*



## ***Kreu IV***

### ***Viti financiar – ekspertët***

#### ***Neni 14***

##### ***Viti financiar***

*Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përbashimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor.*

#### ***Neni 15***

##### ***Ekspertët***

*Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtua e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.*

## ***Kreu 5***

### ***Prishja – riorganizimi i shoqërisë***

#### ***Neni 16***

##### ***Prishja dhe likuidimi***

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke*

*Emilando Ricas*  




*caktuar një apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likujdim e sipër”. Prishja e shoqëris tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.*

*Likujdimi kryhet nga likujduesit që janë emëruar nga Ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.*

### **Neni 17**

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

*Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*

### **Neni 18**

#### **Baza ligjore**

*Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.*

*Emilando Kicaj*  


***Neni 19***

***Mosmarrëveshjet***

*Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.*

*Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:*

***ORTAKU THEMELUES***

***I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***“Vernici Superiori Italiani” Sh.P.K.***

*Emilando Rica*

